# Kukesi/ Revolte dhe protesta per vendimet e Disiplines

nga AlbaniaSoccer
E mërkurë, 11 Dhjetor 2013 21:36




Sapo mesuan vendimet e Komisionit te Disiplines, tifozet e Kukesit kane shperthyer ne revolte. Protesta ne qytet dhe shume sharje ne internet drejtuar FSHF-se dhe Armando Dukes. Drejtuesit gjithashtu kane kerkuar shpjegime dhe tani kane bere gati ankesen qe do te dergojne ne Komisionin e Apelit. Disiplina denoi Kukesin me heqjen e tre pikeve, mbylljen e stadiumit per kater ndeshje dhe pezullimin e trajnerit Shensoi me 12 ndeshje. E gjithe kjo erdhi pas incidenteve ne fund te ndeshjes me Skenderbeun ku disa tifoz tentuan te godisnin gjyqtarin Enea Jorgji.